



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË
PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE**

Nr. 2201/1 Prot.

Tiranë, më 9.6.2020

NJOFTIM PËR VENDE PUNE

A. Lëvizja paralele brenda të njëjtës kategori

Në zbatim të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.5.2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, Kreu V – "Lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë", nenit 26 dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 242, datë 18.3.2015 "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese", i ndryshuar, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, njofton se;

a) Në Administratën e tij ka 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Administrimit.

Paga e pozicionit- II-b

Në përputhje me Vendimin nr. 48, datë 22.7.2016, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 55/2014 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave", të ndryshuar".

Pozicioni më sipër u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori në të gjitha institucionet, pjesë e shërbimit civil, me procedurën e lëvizjes paralele. Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

ILDKPKI ka vendosur që procedura e plotësimit të vendit të lirë për pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Administrimit, të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat specifike për praninë në këtë kategori. Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë) aplikohet në të njëjtën kohë.

b) Pëshkrimi i detajuar i vendit të punës

Drejtori i Financës dhe Administrimit, në ILDKPKI, ka përgjegjësi për koordinimin dhe ndjekjen e punës në hartimin e politikave institucionale për zbatimin e rregullave dhe dispozitave ligjore në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe burimeve financiare të alokuara nga Buxheti i Shtetit. Si dhe zbatimin e objektivave dhe politikave ekonomike të veprimtarisë institucionale në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9936 "Për Menaxhimin



ILDKPKI

Rr. "Reshit Çollaku". Tiranë, Shqipëri, Tel + 355 42 259 461, www.ildkpkj.al, info@hidaa.gov.al

Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, në kuadër të administrimit të rregullave të menaxhimit financiar, mbajtjen e llogarive dhe përgatitjen e pasqyrave financiare. Organizimi dhe kontrolli i veprimtarisë së Buxhetit, Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Gjithashtu Drejtori i Financës dhe Administrimit, në ILDKPKI, është përgjegjës për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e punës së Drejtorisë, mbikëqyrjen e stafit dhe mbikëqyrjen e kryerjes së detyrave të caktuara dhe koordinon punët brenda sektorëve në varësi.

c) Kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda të njëjtës kategori për të cilën aplikon. (*kategoria II/b*)
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi. (*të vërtetuar me një dokument nga institucioni*)
- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “*Mirë*” apo “*Shumë mirë*”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të ketë përfunduar studimet e larta Universitare në Shkenca Ekonomike, i diplomuar në profilin financë kontabilitet ose ekonomist me Diplomë të Nivelit të Dytë (DND) ose Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë (DIND) apo të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë.
- Të ketë përvojë të gjatë në drejtim të menaxhimit dhe kontrollit financiar, jo më pak se 5 vjet në profesion.
- Të jetë individ me etikë, aftësi komunikuese, organizative, menaxhuese dhe intelektuale.
- Të ketë trajnime në lidhje me fusha që trajtojnë fushën e kontabilitetit, financave, dhe administratës publike.
- Të ketë njohuri në një gjuhë të huaj.
- Të ketë njohuri në programe bazë kompjuterike Microsoft Office dhe programe financiare (Financa 5, Alpha Nett, Alpha buxhetor).
- Të jetë i çertifikuar nga institucione të njohura nga Ministria e Financës për njohuri në fushën e auditit të brendshëm dhe/ose të ketë njohuri në fushën e inspektimit financiar ose kontrollit.
- Nuk duhet të shprehë publikisht bindjet apo preferencat politike.
- Aftësi në komunikim me eprorët, kolegët dhe vartësit.
- Aftësi të organizimit dhe të drejtimit të punës në grup, aftësi gjykimi dhe hartimi të dokumentave të ndryshëm.

ç) Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi, në Sektorin e Protokoll-Arkivës dhe Administrimit të Deklaratave të Pasurive, këto dokumenta:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
- Jetëshkrimi i plotësuar;
- Fotokopje e diplomës. (*përfshirë dhe diplomën bachelor*) Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njehësuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- Fotokopje e listës së notave;
- Fotokopje e librezës së punës, (*të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën*);



- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Vërtetim i gjendjes shëndetësore;
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- Fokopje e kartës së identitetit.

Mosparaqitje e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

d) Pranimi i dokumentave do të bëhet brenda datës 22.6.2020

dh) Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak

Në datën 24.6.2020 do të shpallet lista e vlerësimit paraprak e kandidatëve që do të vazhdojnë konkurrimin (në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të ILDKPKI dhe në stendën e informimit të publikut). Këta do të jenë ata që plotësojnë kushtet minimale të lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, të kërkuara më sipër.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme, do të njoftohen individualisht nga njësia përgjegjëse e ILDKPKI, nëpërmjet adresës së e-mail.

Kandidatët që rezultojnë të pakualifikuar, kanë të drejtë të paraqesin ankesat me shkrim në njësinë përgjegjëse, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

e) Konkurrimi- intervista me gojë do të bëhet në datën 8.7.2020, në mjediset e ILDKPKI, në orën 10-00.

ë) Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të vlerësohen në intervistë. Konkurrimi - intervista me gojë do të bazohet në njohuritë për specialitetin,

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- Ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontrollin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9367 datë 07.04.2005, “Për pandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 60/2016, datë 2.6.2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”;
- Kodi Penal dhe Kodi i Procedurave Penale;
- Kodi i Procedurave Administrative;
- Kodi Civil dhe i Procedurës Civile;



ILDKPKI

Rr “Reshit Çollaku”, Tiranë, Shqipëri, Tel. + 355 42 259 461, www.ildkpkj.al, info@hidaa.gov.al

- Ligji nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”;
- Ligji nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;

f) Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen nga “Komiteti i Pranimit për Lëvizjen Paralele”, i ngritur pranë ILDKPKI. Konkurrimi për lëvizjen paralele përfshin dy faza;

- a) Verifikimi paraprak, nëse kandidatët plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme.
- b) Vlerësimi i kandidatëve ku përfshihet vlerësimi i përvojës në punë, trajnimet, kualifikimet dhe intervista e strukturuar me gojë.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 100, të cilat ndahen përkatësisht:

- a) 40 pikë për dokumentacionin e dorëzuar i ndarë; 20 pikë për përvojën, 10 pikë për trajnimet apo kualifikime të lidhura me fushën përkatëse dhe 10 pikë për certifikimin pozitiv ose për rezultatet individuale në punë
- b) 60 pikë për intervistën e strukturuar me gojë.

g) Mënyra e njoftimit dhe komunikimit

Lista e fituesve me të paktën 70 pikë (70% të pikëve) do të komunikohet në datën **9.7.2020**.

Ankesat nga kandidatët paraqiten pranë KPND, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

Njoftimi përfundimtar për shpalljen e kandidatit fitues për procedurën e lëvizjes paralele, do të bëhet: në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*”, në faqen zyrtare të ILDKPKI dhe në stendën e informimit të publikut.

Nëse nuk ka fitues, nga procedura e lëvizjes paralele, konkurrimi do të vazhdojë sipas Kreut V – “*Lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë*”, të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.5.2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 242, datë 18.3.2015 “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*, i ndryshuar, Kreu III, “*Ngritja në detyrë*”.

B. Ngritja në detyrë

- a) Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.
- b) Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në ILDKPKI, apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë. ILDKPKI ka vendosur që procedura e plotësimit të vendit të lirë për pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Administrimit, të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin/vendet e lira.



ILDKPKI

Rr. “Reshit Çollaku”, Tiranë, Shqipëri, Tel. + 355 42 259 461, www.ildkpkj.al, info@hidaa.gov.al

c) Kushtet minimale që duhet të plotësojnë kandidatët për këtë procedurë janë:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar;
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”.
- Të ketë përfunduar studimet e larta Universitare në Shkenca Ekonomike, i diplomuar në profilin financë kontabilitet ose ekonomist me Diplomë të Nivelit të Dytë (DND) ose Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë (DIND) apo të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë.
- Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi.
- Të ketë njohuri të gjera dhe aftësi shumë të mira në fushën e së drejtës dhe të procedurave.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të ketë një ekperience pune mbi 5 vjet në profesion.
- Të ketë trajnime në lidhje me fusha që trajtojnë fushën e kontabilitetit, financave, dhe administratës publike.
- Të ketë njohuri në një gjuhë të huaj.
- Të ketë njohuri në programe bazë kompjuterike Microsoft Office dhe programe financiare (Financa 5, Alpha Nett, Alpha buxhetor).
- Të jetë i çertifikuar nga institucione të njohura nga Ministria e Financës për njohuri në fushën e auditit të brendshëm dhe/ose të ketë njohuri në fushën e inspektimit financiar ose kontrollit
- Nuk duhet të shprehë publikisht bindjet apo preferencat e tij politike.
- Aftësi në komunikim me eproret, kolegët dhe vartësit.
- Aftësi të organizimit dhe të drejtimit të punës në grup, aftësi gjykimi dhe hartimi të dokumentave të ndryshëm.
- Nuk duhet të shprehë publikisht bindjet apo preferencat e tij politike;

Kandidatët e tjerë nga jashtë shërbimit civil, duhet të plotësojnë;

Kërkesat e Përgjithshme

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil në përputhje me nenin 21 të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;

- të jetë shtetas shqiptar;
- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji;



Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon;

- Të ketë përfunduar studimet e larta Universitare në Shkenca Ekonomike, i diplomuar në profilin financë kontabilitet ose ekonomist me Diplomë të Nivelit të Dytë (DND) ose Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë (DIND) apo të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë.
- Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi.
- Të ketë njohuri të gjera dhe aftësi shumë të mira në fushën e së drejtës dhe të procedurave.
- Kriterin e ekperiencës në punë mbi 10 vjet në profesion si financier ose ekonomist, në lidhje me fusha që trajtojnë fushën e kontabilitetit, financave dhe/ose administratës publike.

ç) Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

Kandidatët duhet të dërgojnë me postë ose dorazi, në Sektorin e Protokoll-Arkivës dhe Administrimit të Deklaratave të Pasurive, këto dokumenta:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
- Jetëshkrimi i plotësuar;
- Fotokopje e diplomës. *(përfshirë dhe diplomën bachelor)* Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëhere ai duhet ta ketë të njësuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- Fotokopje e listës së notave;
- Fotokopje e librezës së punës;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Vërtetim i gjendjes shëndetësore;
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim;
- Fokopje e kartës së identitetit.

Mosparaqitje e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

d) Kandidatët duhet të dorëzojnë, të gjitha dokumentat e cituara më sipër brenda datës 29.6.2020.

dh) Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak

Lista e vlerësimit paraprak e kandidatëve që do të vazhdojnë konkurrimin, do të shpallet në datë 6.7.2020, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të ILDKPKI, www.ildkpkj.al, dhe në stendën e informimit të publikut.

Këta do të jenë ata që plotësojnë të gjitha kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të kërkuara më sipër.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht, për shkaqet e moskualifikimit.



Ankesat nga kandidatët paraqiten pranë njësisë përgjegjëse, brenda 5 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

e) Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet konkurrimi

Konkurrimi - intervista me gojë do të bazohet në njohuritë për specialitetin,

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- Ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004, “Për kontrollin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9367 datë 07.04.2005, “Për pandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 60/2016, datë 2.6.2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”;
- Kodi Penal dhe Kodi i Procedurave Penale;
- Kodi i Procedurave Administrative;
- Kodi Civil dhe i Procedurës Civile;
- Ligji nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”;
- Ligji nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;

ë) Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Konkurrimi do të mbështetet në parimet e shanseve të barabarta, meritës, aftësive profesionale e mosdiskriminimit dhe do të kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës transparent e të drejtë. Në vlerësimin e kandidatëve përfshihen;

- a) Vlerësimi i jetëshkrimit, përvoja dhe trajnimet.
- b) Vlerësimi me shkrim.
- c) Intervista e strukturuar me gojë.

Kandidatët do të vlerësohen nga “Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë”, i ngritur pranë ILDKPKI. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 100, të cilat ndahen përkatësisht:

- 20 pikë për dokumentacionin e dorëzuar,
- 40 pikë për intervistën e strukturuar me gojë,
- 40 pikë për vlerësimin me shkrim.

f) Konkurrimi-testimi me shkrim do të bëhet, në mjediset e ILDKPKI në datë 21.7.2020 në orën 11:00.

g) Mënyra e njoftimit dhe komunikimit

Lista e fituesve me të paktën 70 pikë (70% të pikëve)

Kandidatë fitues janë kandidatët që marrin të paktën 70 pikë e lart.

Ankesat nga kandidatët paraqiten pranë KPND, brenda 3 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual për rezultatin e vlerësimit dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.



Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, ILDKPKI do të njoftojë ata individualisht, në mënyrë elektronike për rezultatet (*nëpërmjet adresës e-mail*)

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën “*Ngritje në detyrë*”, do të marrin informacion në faqen e ILDKPKI, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure.

- Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak.
- Për datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi.

Njoftimi do të bëhet: në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të ILDKPKI, www.ildkpkj.al dhe në stendën e informimit të publikut.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për këtë procedurë, duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e ILDKPKI.

Për sqarime, mund të kontaktoni në adresën: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Rruga “Reshit Çollaku”, Tiranë.

ILDKPKI
NJËSIA PËRGJEGJËSE